



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 151/3 Prot.

Tiranë, më 23.06.2025

V E N D I M

Nr. 152, Datë 23.06.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 201, datë 30.09.2024¹, e paraqitur nga z. A.M kundër Drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë (ZVAP Tiranë), Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), në të cilën pretendon diskriminimin e fëmijëve të tij të mitur: O.M, S.M dhe A.M, për “çdo shkak tjetër²” dhe për shkak të “gjendjes ekonomike³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, në dokumentacionin plotësues datë 09.10.2024 dhe me e-mail-et datë 29.10.2024, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se:

¹ Ankesa është plotësuar me dokumentacionin e dërguar me e-mail-in datë 29.10.2024.

² Për shkak të denoncimeve të tij në portalin Zhurma.AL.

³ Shtuar si pretendim gjatë seancës dëgjimore, datë 23.01.2025. Ankuesi nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion për të provuar/faktuar gjendjen ekonomike.

“Fëmijët e mi S, O dhe A.M kanë qenë nxënës në shkollën 9-vjeçare “Ardian Klosi” në Tiranë, respektivisht në klasat e 6 dhe të 7-të, viti akademik 2023-2024.

Nga ana e mësuesve të kësaj shkolle ata janë dhunuar, bullizuar dhe dëmtuar nga veprimet e kundërligjshme të dhunës së ushtruar, në dëm të integritetit të tyre fizik, emocional dhe psikik. Konkretisht, mësuesi i kësaj shkolle, z. P.Gj ka dhunuar në mënyrë sistematike fëmijët e mi, madje i ka dënuar ata në forma represive përmes qëndrimit në banjat e shkollës, apo qëndrimit me orë të tëra në këmbë, me fytyrë nga muri. Pasi u dhunuan fëmijët e mi, kur u vura në dijeni të kësaj ngjarjeje të rëndë, kam kërkuar (datë 15.09.2023) ngritjen e Komisionit të Disiplinës në shkollë, me qëllim vënien para përgjegjësisë disiplinore të mësuesit të lartpërmendur. Pavarësisht ankesave dhe kërkesave të mia të vazhdueshme, Komisioni i Disiplinës së shkollës, kryesuar nga Drejtoresha, nuk kanë marrë masat e duhura për parandalimin, dokumentimin e ngjarjes dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve. Masa disiplinore ndaj mësuesit P.Gj është dhënë vetëm pasi ky ka dhunuar fëmijën e kolegut të tij, mësues të kësaj shkolle. Pra, ankesat e mia në drejtim të dhunës së ushtruar ndaj fëmijëve të mi, nuk janë marrë parasysh nga ana e tyre, madje fëmijët e mi nuk janë asistuar nga shërbimi i psikologut, i detyrueshëm në këto raste.

Pas këtyre veprimeve të vazhdueshme të mësuesve kundrejt fëmijëve të mitur jam detyruar t'i transferoj ata në shkollën “Hasan Prishtina”, Tiranë. Kjo për shkak se subjekti dhunues, z. P.Gj, jo vetëm nuk u dënua sipas veprës që kishte konsumuar, fakt ky i provuar nga Komisioni i Disiplinës, por mori një masë thyerje etike thjesht formale, pa asnjë efekt juridik ndëshkimor, madje dhe duke dalë si triumfator nga Komisioni i Etikës. Për këtë shkak, i kam kërkuar të gjitha drejtorive të arsimit parauniversitar t'i transferonin fëmijët në një tjetër shkollë. Ky transferim u bë mbi bazën e urdhrit verbal të dhënë nga Drejtori i Kurrikulës pranë ZVAP Tiranë, z. S.K. Edhe rikthimi i fëmijëve të mi, në shkollën “Ardian Klosi”, është bërë po me urdhër/kërcënim verbal, nga z. S.K. Edhe pse fëmijët e mi kanë zhvilluar rreth dy muaj mësim në këtë shkollë, për llogari të shkollës “Ardian Klosi”, mësuesit e shkollës “Ardian Klosi” i kanë vënë në mënyrë të paligjshme mungesa, duke mos i kualifikuar fëmijët e mi në vitin shkollor pasardhës, fakt ky i provuar nga shkresa e përcjellë nga ana e drejtoreshës së shkollës “Ardian Klosi”. Pra, mësuesit e kësaj shkolle, kanë vënë mungesa fiktive dhe nuk kanë marrë parasysh frekuentimin e zhvilluar nga fëmijët e mi në shkollën “Hasan Prishtina”.

Pasi znj. R.A, Drejtoresha e AKAP më premtoi verbalisht se do detyronte ZVAP Tiranë për të më dhënë aktin e motivacion të transferimit të fëmijëve të mi, pra arsyen pse ata po transferoheshin nga njëra shkollë tek tjetra, ky premtim nuk u mbajt. Në këto kushte, z. S.K në cilësinë e Drejtorit të Kurrikulës në ZVAP Tiranë, më ka detyruar t'i heq fëmijët e mi nga shkolla “Hasan Prishtina” dhe t'i transferoja sërish në shkollën “Ardian Klosi”. Ky shtetas më ka detyruar t'i hiqja fëmijët e mi, në të kundërt do t'i hiqte vetë.

I gjendur në këto rrethana i kam transferuar sërish fëmijët në shkollën “Ardian Klosi”. Edhe pas transferimit, vijuan masat represive dhe denigruese të dinjitetit të fëmijëve të mi, nga ana e mësuesit P.Gj, duke i dënuar në tualetet e shkollës për orë të tëra.

Pasi u ndërpre në marrëdhëniet e punës të mësuesit P.Gj me shkollën, ndaj fëmijëve të mi filluan sërish veprimet e paligjshme, këtë herë nga ana e mësuesve kujdestare. Konkretisht, mësuesit krijonin mbledhje formale, pa qenë fëmijët e mi subjekt përfshirës në to. Këto mbledhje konstituheshin pikërisht për t'i bërë fëmijët e mi subjekte përfshirëse në konfliktet që kishin nxënësit e tjerë në këtë institucion, madje duke përfshirë edhe prindërit e nxënësve në ato mbledhje. Në realitet, fëmijët e mi nuk kishin asnjë lidhje me ngjarjet, konfliktet dhe problematikat që diskutoheshin në këto mbledhje fiktive, madje në fund këto komisione konkludonin vërtet që nuk kishin asnjë lidhje fëmijët e mi me konfliktet eventuale të nxënësve të tjerë të shkollës.

Në raste të tjera (rreth 3 raste), mësuesit kujdestar më lajmëronin në telefon duke më shprehur se fëmijët e mi janë rrahur me nxënës të caktuar dhe se drejtoria kërkonte mbledhje me mua si prind, në cilësinë e përfaqësuesit të tyre ligjor.

Edhe në raste të tjera, ku nxënës të kësaj shkolle konfliktoheshin me nxënës të tjerë, vetëm për faktin se ishin prezent në ngjarje, bëhej fëmija im. Pra, mësuesit krijonin alibi dhe stigmatizonin për çdo konflikt që ndodhte në institucion, fëmijët e mi, duke drejtuar gishtin gjithmonë tek ata. Konkretisht, mësuesja e shkollës i ka dhënë adresën time telefonike familjarit të një nxënësi tjetër, i cili në mënyrë të paligjshme donte të merrte fëmijët e mi në makinë. Herën e tretë (datë 19.03.2024) një nxënës i klasës së IX-të dhunoi O, djalin tim të vogël në sy të drejtoreshës, nëndrejtoreshës, mësueses kujdestare të dhunuesit dhe në sy të psikologut. Këto persona të përmendur më sipër në atë çast nuk reagueshin fare, falë zotit i pa profesori i fizikulturës nga larg z. B.L dhe ka shkuar me vrap, duke ja hequr agresorit nga duart djalin tim të vogël, sepse ai po kërkonte ta ripërplaste tek kangjellat e shkollës. Për situatën e ndodhur nuk më ka njoftuar askush brenda orarit zyrtar. Mësueset kujdestare më kanë shkruar të dyja rreth orës dy të asaj dite, duke më dërguar afërsisht të njëjtin tekst të dyja, ku më informonin që fëmijët e mi paskan rrahur një djalë të klasës së IX-të. Më pas pyeta fëmijët dhe rezultoi se O dhe S i kishte rrahur nxënësi i klasës së IX-të. Pas kësaj kam marrë fëmijët dhe jam drejtuar urgjentisht tek Komisariati nr. 4, Tiranë ku bëmë kallëzim për agresorin dhe për stafin për shpërdorim detyre dhe për fshehje të vërtetës dhe mbulimin e aktit.

U jam drejtuar vazhdimisht me ankesa, kërkesa, etj, ZVAP Tiranë, AKAP, MAS-it, etj, por nga këta të fundit nuk janë marrë seriozisht, këto ankesa institucionale.

Në kushtet e dhunimit barbar të fëmijëve të mi, masave ndëshkimore të atilla që kanë dëmtuar rëndë shëndetin e tyre psikik dhe emocional, jam detyruar t'i largoj fëmijët e mi nga shkolla dhe i kam nisur për shkollim dhe rehabilitim jashtë shtetit, pasi autoritetet e arsimit parauniversitar nuk po merrnin masa për trajtimin e tyre të veçantë sipas legjislacionit në fuqi, për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, etj, përkundrazi i ngelën në klasë me dokumente fallco.

Këto veprime të kundërligjshme dhe disfavorizuese ndaj fëmijëve të mi, janë marrë me qëllim të posaçëm si formë hakmarrje indirekte, nga veprimtaria që unë zhvilloj në masmedia, në portalet online, ku unë administroj një faqe publike e quajtur “Zhurma.AL”. Në këtë portal unë

vazhdimisht denoncoj me zë dhe figurë veprimet e paligjshme të administratës publike, dhe veprimeve të paligjshme të mësuesve, programet e tyre, ryshfetin, etj, dhe bazuar në këto akte të ndërgjegjësimit të opinionit publik nga ana ime, ku kam ekspozuar dhe informuar vazhdimisht publikun mbi gjendjen e strukturave të arsimit parauniversitar në Shqipëri, mësuesit e shkollës së bashku me autoritetet-subjekte ndaj të cilave drejtohet kjo ankesë, kanë marrë masa represive dhe ndëshkimore ndaj fëmijëve të mi, me shkak të fshehur diskriminues dhe goditjes së veprimtarisë sime publike, që unë zhvilloj në portalin e administruar nga ana ime⁴.

Masat antidisiplinore ndaj fëmijëve të mi janë marrë menjëherë pasi unë kam denoncuar në fillim të vitit shkollor 2023, datë 10.09.2023, në portalin Zhurma.AL në facebook, denoncimet publike mbi korrupsionin dhe ryshfetin, sikurse metodat shtrënguese ndaj fëmijëve, prindërit e të cilëve ankoheshin tek portali i administruar nga ana ime, mbi veprimet e kundërligjshme të mësuesve, ku këta të fundit kërkonin të përfitonin të mira materiale në kundërshtim me ligjin”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rregullimin e pasojës duke i kualifikuar fëmijët për vitin shkollor 2023-2024⁵.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 5, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një

⁴ <https://www.facebook.com/share/v/6crbZAZBoVXWN8CF/>
<https://www.facebook.com/share/v/xkzng9xjTCV1eJmo/>
<https://www.facebook.com/share/v/ogPrvnC96exJrm1e/>
<https://www.facebook.com/share/v/eFESafxifFN7K424/>
<https://www.facebook.com/share/v/VwSx7KoG6SBMUuEm/>
<https://www.facebook.com/share/v/GM2RDy36Gh8Vv7cC/>

⁵ Kërkesë e bërë me email-in datë 12.02.2025.

trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte paqartësi, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 16.10.2024 dhe me shkresën nr. 1335/4, datë 28.10.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga subjekti ankues që të plotësojë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Subjekti ankues, me e-mail-et datë 09.10.2024 dhe 29.10.2024, dërgoi informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

- Me shkresën nr. 1335/5, datë 12.11.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet kundër të cilëve ishte bërë ankesa, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:

Nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”:

- Argumentimin Tuaj, për të gjitha pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.
- Kopje të plotë të procedurës së ndjekur lidhur me shqyrtimin e ankesës së z. A.M, të bërë në datë 15.09.2023. Masat e marra nga Komisioni i Etikës dhe i Disiplinës.
- Kopje të plotë të procedurës së ndjekur lidhur me vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve me mësuesin P.Gj.
- Informacion dhe dokumentacion lidhur me procedurën e ndjekur nga shkolla për transferimin e fëmijëve të z. A.M.
- Informacion dhe dokumentacion lidhur me frekuentimin e mësimit nga fëmijët e z. A.M, në shkollën “Ardian Klosi” dhe “Hasan Prishtina” dhe si i janë llogaritur mungesat.
- Informacion dhe kopje të provesverbaleve të mbledhjeve të organizuara nga klasat e nxënësve, objekt i ankesës, lidhur me problematikën e ngritura nga ankuesi.

- Informacion mbi masat e marra nga Drejtoria e shkollës për asistimin e fëmijëve me shërbimin e psikologut.
- Kopje të plotë të korrespondencës së shkollës me z. A.M.

ZVAP Tiranë:

- Informacion dhe dokumentacion lidhur me procedurën e ndjekur nga ZVAP Tiranë për transferimin dhe frekuentimin e mësimit nga ana e fëmijëve të z. A.M.
- Procedurën e ndjekur për shqyrtimin e ankesës së z. A.M të datës 18.09.2023.
- Procedura e ndjekur për trajtimin e kërkesës së z. A.M, datë 22.04.2024 (për të gjetur shkollë tjetër për fëmijët).
- Kopje të plotë të korrespondencës së ZVAP Tiranë me z. A.M.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar:

- Procedurën e ndjekur për shqyrtimin e ankesës së z. A.M, të datës 26.09.2023.
- Procedura e ndjekur për trajtimin e kërkesës së z. A.M, datë 22.04.2024 (për të gjetur shkollë tjetër për fëmijët).
- Procedura e ndjekur për trajtimin e kërkesës së z. A.M, datë 30.04.2024 (për çrregjistrimin e fëmijëve).
- Kopje të plotë të korrespondencës së AKAP me z. A.M.

Ministria e Arsimit dhe Sportit:

- Procedura e ndjekur për shqyrtimin e ankesës së z. A.M, datë 03.11.2023 (për transferimin e fëmijëve).
- Procedura e ndjekur për trajtimin e kërkesës së z. A.M, datë 22.04.2024 (për të gjetur shkollë tjetër për fëmijët).
- Kopje të plotë të korrespondencës mes MAS dhe z. A.M.

Me shkresën me nr. 7152, datë 21.11.2024, Ministria e Arsimit dhe Sportit dërgoi dokumentacionin e kërkuar.

Me shkresat me nr. 355 dhe nr. 357, datë 21.11.2024, shkolla “Ardian Klosi” dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe informoi se: *“Shkolla nuk i ka kërkuar në asnjë moment z. A.M largimin e fëmijëve nga shkolla, përkundrazi jemi përpjekur që ata të vijojnë mësimin normalisht në institucionin tonë me gjithë përkujdesjen e duhur. Bazuar në Urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023 për “Miratimin e rregullores për përdorimin e sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar”, neni 7, pika 7, ZVAP “Miraton ose refuzon në mënyrë të argumentuar, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, aplikimet për transferim të nxënësve brenda dhe jashtë ZVAP-së, si dhe të nxënësve të ardhur nga jashtë shtetit”.*

Aplikimet për transferim, regjistrim apo transferim në shkollë tjetër bëhet nga prindi nëpërmjet portalit e-albania”.

Me shkresën me nr. 356, datë 21.11.2024, shkolla “Ardian Klosi” në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Ankesa e ardhur nga z. A.M me datë 15.09.2023 (ditë e premte) i referohet dy mësuesve dhe konkretisht z. P.Gj dhe znj. H.Z. Pas marrjes së ankesës me datë 18.09.2023 (ditë e hënë), drejtoresha e shkollës i drejtohet Komisionit të Etikës dhe sjelljes në shkollë me shkresën me nr. 523, gjithashtu është vënë në dijeni psikologu i shkollës z. E.K për shqyrtimin e situatës dhe marrjen e të gjitha hapave për të parë, nëse jemi përpara faktit të ushtrimit të dhunës.

Përsa i përket qëndrimit në banjat e shkollës, mund të themi se janë pyetur të gjithë mësuesit që japin mësim në atë klasë, pasi ky pretendim është ngritur edhe verbalisht në drejtori, por ata e mohojnë këtë fakt.

Mbështetur në Rregulloren e Funksionimit të Institucioneve Arsimore Parauniversitare, Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020 për “Miratimin e rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, u ngrit Komisioni i Etikës së shkollës. Drejtori i IA-së nuk merr pjesë në komision.

Komisioni i Etikës ndaj mësuesve P.Gj dhe H.Z, propozoi masat disiplinore “Qortim” për të dy.

Me datë 21.09.2023, mbledhet Komisioni i Disiplinës në shkollë mbi shqyrtimin e masave të propozuara nga Komisioni i Etikës dhe sjelljes. Komisioni i Disiplinës pasi dëgjoi të gjitha konkluzionet e nxjerra nga Komisioni i Etikës dhe konkluzioneve të nxjerra nga psikologu i shkollës, i cili pohon para Komisionit se nuk ka patur dhunë për dy rastet e konstatuara, si dhe raste të tjera të veprimeve që bien ndesh me Kodin e Etikës, ky komision vendosi që ndaj mësuesve të merren masat: për z. P.Gj masa disiplinore “Vërejtje” dhe ndaj mësueses H.Z masa disiplinore “Qortim”.

Nxënësit M kanë qenë në vëmendjen e shërbimit psikosocial të shkollës, konkretisht psikologut z. E.K si i vetmi punonjës i këtij shërbimi në institucion, që nga fillimi i vitit shkollor 2023-2024. Psikologu i shkollës ka qenë pjesë e trajtimit të ankesës së prindit, konkretisht gjatë dhënies së dëshmisë të nxënësve A dhe S. M, para Komisionit të Etikës. Gjatë këtij procesi u sigurua që ndaj nxënësve M të mos kishte asnjë presion apo ndikim që mund t'i pengonte ato të shpreheshin.

Në vijim për të sqaruar rrethanat e ngjarjeve për të cilat ishin ngritur pretendime, psikologu ka zhvilluar dy takime me nxënësit e klasës VII-A, pasi ato kishin qenë prezent në të dyja rastet. Takimi i parë u zhvillua me prezencën e dy vëllezërve M (A dhe S) dhe takimi i dytë pa praninë e tyre me qëllim marrjen e një informacioni sa më të balancuar dhe të paanshëm.

Në muajin dhjetor 2023, babai i nxënësve paraqiti sërish në drejtorinë e shkollës një ankesë për të njëjtin mësues. Për të verifikuar pretendimet e ngritura psikologu zhvilloi një takim të hapur me nxënësit e klasës VII-A, më pas një takim të dytë në zyrën e tij me disa prej nxënësve të kësaj klase që shprehën shqetësim në lidhje me sjelljen e mësuesit në fjalë. Në përfundim u realizua një pyetësor me nxënës të klasave VII-A, VIII-B. Rezultatet, konkluzionet e takimeve dhe pyetësorëve iu paraqitën drejtorisë së shkollës.

Në muajin mars nxënësi O.M ka pasur një konflikt me një nxënës tjetër të shkollës. Babai i nxënësve refuzoi të merrte pjesë në takimin e zhvilluar mes prindërve dhe nuk lejoi fëmijët e tij të ndiqnin shkollën javët vijuese. Prindi është vënë në dijeni nga mësuesit kujdestarë për rrezikun e moskualifikimit në klasë të fëmijëve të tij për shkak të mungesave, por përsëri nuk ka pranuar t'i sjellë në shkollë. Duke parë që fëmijët po pengoheshin nga e drejta e tyre për arsimim, psikologu i shkollës e ka raportuar rastin tek Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), pranë Njesisë Bashkiake Nr. 4.

Sa i takon pretendimit të prindit se: “në datë 19.03.2024, një nxënës i klasës së IX-të dhunoi djalin e tij O në sy të dhe në sy të psikologut”, psikologu sqaron se ky është një pretendim plotësisht i pavërtetë, ai nuk ka qenë prezent në vendngjarje, kur ka ndodhur situata e përmendur sepse së bashku me drejtoreshën dhe mësueset ndihmëse kanë qenë prezent në menaxhimin e një situate.

Bazuar në Urdhrin nr. 31/2020, kreu VIII, neni 29 dhe 32, thekson se këshillimi i vazhdueshëm i nxënësve me psikologun realizohet vetëm me miratim të shkruar nga prindi, sipas një formulari të posaçëm. Prindi nuk ka dhënë aprovimin e tij me shkrim për këshillime individuale të fëmijëve me psikologun, dhe janë zhvilluar këshillime vetëm kur nxënësit kanë kërkuar të shprehnin diçka dhe prindi është vënë në dijeni nga mësueset kujdestare të klasave përkatëse (VI-B, VII-A).

Gjatë vitit shkollor 2023-2024, me prindin e nxënësve janë zhvilluar disa takime, i kemi dhënë përgjigje të dokumentuara për shqetësimet që ka ngritur, kemi diskutuar mbi ecurinë e fëmijëve në shkollë. Formularët e këshillimeve individuale me nxënësit janë konfidenciale, kopje të tyre nuk mund të dërgohen pa kërkesë dhe autorizim të posaçëm.

Nxënësit A.M dhe S M nxënës në klasën e 7 (shtatë) si dhe O.M nxënës në klasën e 6 (gjashtë) fëmijët e z. A.M kanë munguar në shkollë si më poshtë: A.M, 388 mungesa ose 37%; S.M, 474 mungesa ose 46% dhe O.M, 419 mungesa ose 44%.

Drejtorja e shkollës së bashku me mësuesit kujdestarë kanë patur komunikim të vazhdueshëm me prindin ku kanë kërkuar arsyen e mungesave të nxënësve. Nga ana e prindit nuk ka ardhur asnjë raport mjekësor apo justifikim me shkrim dhe për këtë arsye këto mungesa janë llogaritur si të paarsyetuara. Prindi pretendon se fëmijët kanë zhvilluar mësim në shkollën 9-vjeçare “Hasan Prishtina”, Tiranë. Për të qartësuar këtë situatë drejtori i shkollës i drejtohet me një e-mail dhe shkresë zyrtare me datë 29.04.2024, me nr. 115, drejtueses së shkollës znj. L.T ku kërkon të marrë informacion nëse tre nxënësit A.M, O.M dhe S.M kanë frekuentuar këtë shkollë. Drejtuesja e shkollës “Hasan Prishtina” nuk e pranon një fakt të tillë, ajo pohon se nxënësit transferohen vetëm nëpërmjet Sistemit të menaxhimit të informacionit (SMIP) dhe nuk ka patur një kërkesë aktive në sistem. Gjendur në këto kushte, duke parë numrin e lartë të mungesave të cilat po arrinin pragun e 35% të orëve mësimore, psikologu i shkollës i është drejtuar NJMF, ku është raportuar mbi rastin.

Me datë 02.05.2024, drejtori i shkollës i përcjell një shkresë me nr. 117, kujdestarit ligjor prindit z. A.M, ku e bën me dije mbi afrimin e pragut të mungesave 35% të orëve mësimore. Nga ana e prindit nuk ka patur asnjë reagim.

Mësuesja kujdestare e klasës së 7 (shtatë) të nxënësve A M dhe S M, sqaron se në të gjitha takimet formale që janë zhvilluar dhe që janë të planifikuara në axhendën e drejtorisë së shkollës të dokumentuara, prindi Z. A.M nuk ka qenë prezent në asnjë prej tyre. Në shkollë është mbajtur vetëm një mbledhje, e cila nuk ka qenë e planifikuar në axhendën e shkollës, por e organizuar nga Këshilli i Prindërve të klasës në fokus shqetësimit të tyre mbi sjelljen e disa nxënësve, përfshirë këtu edhe fëmijët e z. A.M. Në këtë mbledhje është kërkuar edhe prania e prindit Z. A.M, i cili nuk ka pranuar të paraqitet.

Në asnjë moment drejtoresha e shkollës nuk ka kërkuar takim individual me prindin, pasi takime të tilla zhvillohen nga mësuesi kujdestar dhe vetëm për situata që janë të pamenaxhueshme për mësuesit, mund të bëhen takime në drejtorinë e shkollës.

Mësuesja kujdestare e klasës së 7 (shtatë) të nxënësve A.M dhe S.M, sqaron se asnjëherë nuk ka dhënë adresën telefonike të prindërve palëve të treta, por duke qenë se prindi është pjesë e grupit të klasës të krijuar në platformën sociale në celular, numri i tij dhe i cilitdo prindi është lehtësisht i aksesueshëm nga prindërit e tjerë, pjesë e grupit të klasës.

Lidhur me pretendimin se në datë 19.03.2024 një nxënës i klasës së IX-të ka dhunuar nxënësin O.M në sy të drejtoreshës, nëndrejtoreshës, mësueses kujdestare dhe psikologut, sqarojnë se ky pretendim është i pavërtetë sepse:

Zënka midis fëmijëve ka ndodhur në kohën e pushimit të gjatë, rreth orës 10.40 në pjesën anësore të oborrit të shkollës në momentin që nxënësit po rreshtoheshin të futeshin në mësim dhe mësuesit kanë qenë pranë klasave. Drejtoresha e shkollës së bashku me psikologun dhe mësueset ndihmëse kanë asistuar një nxënëse me aftësi ndryshe për menaxhimin e një situate të vështirë. Nëndrejtoresha e shkollës ka qenë në orë vëzhgimi në një klasë të IV, në arsimin fillor, pasi në kohën e pushimit të madh të AMU arsimit fillor është në mësim. Drejtuesit e shkollës në varësi të situatave mund të jenë prezent ose jo gjatë pushimit, pasi shkolla ka mësues dezhurni ditor dhe javor. Në lidhje me këtë situatë drejtoresha e shkollës është vënë në dijeni nga inspektori i zonës z. A.H, i cili kishte marrë njoftim pas kallëzimit të z. A.M.

Drejtoresha e shkollës e shoqëruar nga psikologu dhe tre mësueset kujdestare të fëmijëve ka shkuar në Komisariat nr. 4, për të dhënë dëshmi mbi ngjarjen.

Lidhur me fjalinë “përkundrazi i ngelën në klasë me dokumente fallco” sqarojmë se:

Ashtu siç kemi shpjeguar edhe më lart mbi frekuentimin e tre nxënësve në shkollën “Hasan Prishtina”, që përbëjnë numrin më të madh të mungesave, janë të pajustificuara nga ajo shkollë. Në fund të vitit shkollor, pa u mbyllur ende rezultatet nga mësuesit, për interesin më të lartë të

fëmijëve, i jemi drejtuar drejtorisë së shkollës “Hasan Prishtina” me shkresë zyrtare me datë 24.06.2024, ku përsëri nuk ka dhënë një përgjigje lidhur me këtë fakt.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se ka gati dy vite që rregjistri i klasave është elektronik dhe çdo veprim i kryer në të është i monitoruar, çdo individ që punon në të, hyn me ID personale dhe nuk ka asnjë mundësi për falsifikim apo ndërhyrje të jashtëligjshme.

Në lidhje me pretendimin se “Masat antidisiplinore ndaj fëmijëve janë marrë menjëherë pasi unë kam denoncuar në fillim të vitit shkollor 2023, në datë 10.09.2023 në portalin Zhurma.al në FB, denoncimet publike mbi korrupsionin dhe ryshfetin,”, sqarojmë se:

Përsa i përket portalit të z. A.M ashtu siç ai thotë Zhurma.AL mund të themi se nuk kemi dijeni të ekzistencës së këtij portali.

Drejtoresha e shkollës sqaron se përgjatë të gjitha viteve si drejtore 2 (vite) dhe 4 (katër) vjet si nëndrejtoreshë në shkollën “Ardian Klosi” nuk ka ardhur asnjëherë qoftë verbalisht apo me shkrim asnjë ankesë nga asnjë prind i shkollës në lidhje me marrjen e ryshfetit nga ana e mësuesve.

Informacion mbi procedurat e shkarkimit të mësuesit z. P.Gj. Hapat e ndjekur nga drejtoria e shkollës sipas legjislacionit në fuqi:

1. Me datë 19.09.2023 mblidhet Komisioni i Etikës dhe sjelljes në shkollë i cili propozon masë disiplinore “Qortim” për të dy mësuesit;
2. Me datë 21.09.2023 mblidhet Komisioni i Disiplinës në shkollë i cili mori masën “Vërejtje” për mësuesin P.Gj dhe masën “Qortim” për mësuesen H.Z.
Masa “Vërejtje” nga Komisioni i Disiplinës iu dha pas konstatimeve të psikologut të shkollës, i cili pohonte se nuk ishim përpara një fakti dhune dhe nuk ishte e provuar dhe e pohuar nga nxënësit e klasës. Mësuesi P.Gj gjatë vitit shkollor 2022-2023 ka treguar profesionalizëm në punë dhe nuk ka patur asnjë ankesë nga asnjë prind që të pretendonte se ai ka ushtruar dhunë.
3. Pas dhënies së masës disiplinore mësuesi P.Gj gjatë muajit nëntor, ndoshta i ndodhur edhe nën presionin e situatës, pati raste të thyerjes së Kodit të Etikës ndaj drejtueses së shkollës, znj. J.I, me fjalë fyese dhe denigruese.
4. Në muajin dhjetor z. A.M i dërgon drejtoreshës së shkollës një mesazh ku e informonte që mësuesi P.Gj kishte dhunuar nxënësin A.M. Menjëherë është bërë një ballafaqim midis mësuesit dhe drejtueses së institucionit, ku mësuesi ka reaguar me fjalë të papërshtatshme. Pas kësaj nga ana e psikologut të shkollës u zhvillua një pyetësor me klasat ku profesori jepte mësim, në të cilin rezultoi se nga pohimet e nxënësve, ushtronte dhunë.
5. Meqenëse masa disiplinore “Vërejtje” e dhënë në muajin shtator nuk ishte shlyer akoma sipas Rregullores së IAP, neni 107, pika 4, si dhe duke patur parasysh rezultatet e pyetësorit, shkeljet në komunikim me eprorin e institucionit, ju dha masa “Largim nga puna”, neni 108, pika 2/b.

6. Me datë 21.12.2023 i bëhet njoftimi për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës, bazuar në Kodin e Punës.
7. Me datë 26.12.2023 mësuesi është paraqitur në shkollë për tu njohur me arsyet e vendimit.
8. Me datë 29.12.2023 është marrë vendimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të njëanshme të punës”.

Me shkresën nr. 3611/1, datë 27.11.2024, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar informoi se për të gjitha kërkesat e paraqitura në AKAP, z. A.M i është kthyer përgjigje nëpërmjet ZVAP Tiranë, pasi është ky institucion që ka tagrin ligjor për trajtimin e problematikave të ngritura nga z. A.M, për fëmijët e tij.

Me shkresën nr. 8715/1, datë 26.11.2024, ZVAP Tiranë, në mes të tjerash informoi se: “Në përgjigje të kërkesës së z. A.M për transferimin e fëmijëve në një shkollë tjetër, u sqarua se si kujdestar ligjor, ai duhet të aplikonte përmes portalit e-albania. Ndërkohë z. A.M ka këmbëngulur për të marrë një motivacion me shkrim për transferimin, kërkesë që nuk parashikohet nga ligji apo aktet e tjera nënligjore. Për të siguruar vijimin e procesit mësimor të fëmijëve në shkollën “Hasan Prishtina” deri në momentin kur z. A.M të aplikonte në sistemin e-albania, kemi komunikuar me këtë shkollë, duke vepruar në interesin më të lartë të fëmijëve për të mos humbur mësimin.

Nga data 13.12.2023, të tre fëmijët e z. A.M janë rikthyer në shkollën “Ardian Klosi” dhe kanë vijuar rregullisht frekuentimin e procesit mësimor deri me datë 20.03.2024. Gjatë kësaj periudhe, ata kanë marrë pjesë aktivisht në të gjitha aktivitetet mësimore dhe jashtëshkollore të organizuara nga institucioni.

Megjithatë, nga data 21.03.2024, situata ka ndryshuar. Të tre nxënësit janë paraqitur në shkollë vetëm për të zhvilluar testet e periudhës së dytë, duke munguar në mënyrë sistematike në orët e rregullta të mësimin. Kjo situatë ka krijuar shqetësim për stafin pedagogjik, pasi mungesa e frekuentimit të rregullt ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e mësimnxënies dhe integrimin e tyre në procesin edukativ.

Transferimi i nxënësve nga një shkollë publike në një tjetër, ose ndërmjet shkollave publike dhe private, realizohet nga kujdestari ligjor përmes aplikimit në portalin e-albania. Në lidhje me këtë proces, z. A.M ka marrë përgjigje nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, ku theksohet:

“Është e drejta juaj si prind dhe këtë të drejtë mund ta ushtroni duke aplikuar në sistemin e-albania”.

Në rast transferimi të nxënësit nga një shkollë në tjetrën, shërbimi psiko-social i shkollave përkatëse ka detyrimin që të trajtojë procesin me profesionalizëm dhe kujdes të veçantë. Në përputhje me rregulloret dhe parimet e konfidencialitetit, dosja personale e nxënësit do të transferohet në mënyrë të sigurt drejt shkollës pritëse, pas një kërkesë zyrtare nga kujdestari ligjor i nxënësit. Ky proces ka për qëllim të sigurojë vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimeve mbështetëse për nxënësin, duke mundësuar një kalim të qetë dhe pa pengesa në mjedisin e ri

arsimor. Në këtë kuadër, garantimi i ruajtjes së informacionit të ndjeshëm dhe të dhënave personale është një parim themelor, i cili zbatohet në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe standardet profesionale të etikës.

Në lidhje me ankesën e z. A.M, e protokolluar pranë nesh me nr. 5202, datë 18.09.2023, ZVAP Tiranë, në zbatim të Urdhrit nr. 295, datë 27.09.2023, ngriti një grup pune për të verifikuar situatën pranë shkollës “Ardian Klosi”. ZVAP Tiranë ka qenë e angazhuar maksimalisht në përfshirjen e fëmijëve të z. A.M në shkollën e re, duke siguruar që ata të kenë një mjedis të përshtatshëm dhe të përkushtuar për të pasur ecuri të mirë në mësim. Grupi i punës përgatiti një raport monitorimi, i cili iu përcoll shkollës “Ardian Klosi” dhe z. A.M në datë 02.10.2023”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi nëpërmjet e-mail-it datë 26.11.2024, është njohur me përgjigjet e institucioneve.

Me email-in, datë 26.12.2024, subjekti ankues ka dërguar kundërshimet e tij, duke informuar si më poshtë: “Së pari mbi pretendimin tim për trajtim çnjerëzor dhe degradues ndaj fëmijëve të mi, konkretisht të qëndrimit në banjot e shkollës, të fëmijëve të mi si pasojë e ndëshkimit ndaj tyre, ndërkohë që shkolla e mohon këtë fakt:

Përsa i përket këtij episodi/fakti, ju theksojmë se ka ndodhur në muajin dhjetor 2023, pra 3 muaj pas ushtrimit të dhunës nga ana e mësuesit P.Gj. Pra ky akt është bërë me qëllim të posaçëm “ndëshkimit” e fëmijëve të mi si pasojë e aplikimit të masës disiplinore nga ana e Komisionit të Disiplinës ndaj mësuesit P.Gj dhe H.Z.

Gjithashtu ju theksoj se, si subjekt ankues i kam paraqitur kërkesë verbale Drejtorit të Shkollës 9 vjeçare “Ardian Klosi”, të administrojë pamjet filmike në atë moment, me qëllim provueshmërinë e këtyre fakteve.

Drejtori i shkollës më ka deklaruar se kamerat do të hapen nga specialisti përkatës pasi ajo nuk kishte njohuri teknike mbi sa sipër. Që nga ai moment nuk kam asnjë dijeni se çfarë është bërë në lidhje me administrimin apo jo, të pamjeve filmike të kërkuara nga ana ime.

Gjithashtu, për të mos e lënë këtë deklaram nga ana ime në kuadër të një kërkesë të paprovueshme, kam paraqitur kallëzim penal ndaj mësuesve kujdestarë për shpërdorim detyre. I kam kërkuar edhe oficerit të Policisë Gjyqësore administrimin e pamjeve filmike ku fëmijët e mi janë dhunuar nga ana e mësuesve.

Në vendimin e mosfillimit të proçedimit penal të organit të akuzës, pasi deklarohet moskompetenca lëndore për këtë kallëzim penal, shquhet ndër të tjera, edhe fakti absurd se, pamjet filmike nuk janë mundur të administrohen për shkak të luhatjeve të tensionit.

Dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve të mi është e pasqyruar në aktet zyrtare si dhe gjithë dokumentacionin e vënë nga ana ime në dispozicion të KMD-së. Gjithashtu, dhuna verbale dhe fizike ndaj fëmijëve të mi është provuar edhe me anë të dokumenteve elektronike ku pranohet nga

vetë mësuesi kujdestar i fëmijëve të mi, në një bisedë telefonike të zhvilluar nga ana e ankuesit me mësuesin kujdestar, në datat 16, 17, 18 shtator 2023.

Vëmë në dijeni KMD se, për sqarimin e konfliktit objekt dhune ndaj fëmijëve të mi, janë mbajtur respektivisht dy procesverbale nga ana e Komisionit të Etikës së shkollës.

Herën e parë kanë qënë prezent dy fëmijët e mi, profesori i matematikës, biologjisë dhe anëtarët e Komisionit të Etikës. Në fund të zhvillimit të Komisionit të Etikës, jam paraqitur edhe unë në cilësinë e kujdestarit/prindit.

Në këtë mbledhje agresori P.Gj (mësues) pranoi dhunën verbale dhe fizike dhe verbale të fëmijëve të mi - në një intensitet sipas tij - të vogël. Ndonëse fëmijët e mi kanë qëndruar 90 minuta në këmbë me fytyrë nga muri - përpara nxënësve të tjerë (2 orë në matematikë dhe 2 orë në lëndën e biologjisë) pra gjithsej 4 orë mësimi në këmbë me fytyrë nga dërrasa.

Herën e dytë kanë mbajtur sërish një procesverbal tjetër ndërmjet mësuesit kujdestar si dhe një anëtar i Komisionit të Etikës. Ju theksojmë se në këtë rast ky procesverbal është mbajtur pa prezencën e fëmijëve të mi apo meje si ankues, sikundër pa prezencën e detyrueshme të psikologut të shkollës.

Për këtë procesverbal nuk kam asnjë dijeni mbi përmbajtjen e tij, por ekzistencën e tij si akt formal e provoj nga telefonata që kam patur me subjektet e sipërpërmendur.

Në lidhje me argumentin tjetër të masave disiplinore për mësuesit P.Gj “Vërejtje” dhe H.Z “Qortim”.

Sa më sipër vërehet mjaft qartë, bazuar edhe në rregullat e logjikës formale se, aty ku nuk ka premisa për ekzistencën e faktit të paligjshëm të dhunës, siç ky Komision ka konkluduar, nuk mund të jepen masa disiplinore ndaj subjekteve të sipërpërmendur. Është e paqartë se mbi ç’baza janë aplikuar këto masa disiplinore në kushtet kur nga ky komision është konkluduar se nuk ka dhunë të ushtruar nga ana e mësuesve.

Mbi pretendimin tjetër se (citojmë): “Bazuar në urdhërin nr. 31/2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të institucioneve parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” Kreu VIII, neni 29 dhe neni 32, këshillimi i vazhdueshëm i nxënësve me psikologun realizohet vetëm me miratim të shkruar nga prindi sipas një formulari të posaçëm. Prindi nuk ka dhënë aprovimin e tij me shkrim për këshillime individuale të fëmijëve me psikologun, janë zhvilluar takime vetëm kur nxënësit kanë kërkuar të shprehnin diçka dhe prindi është vënë në dijeni nga mësuesit kujdestarë të klasave përkatëse.

Subjekti ankues ju thekson se, për asnjë moment psikologu i shkollës nuk ka vënë në dijeni mbi këtë formalitet, duke mos vënë në dispozicion të subjektit ankues formularin e posaçëm me qëllim aprovimin e tij që fëmijët të këshilloheshin individualisht me psikologun. Në këtë kontekst, ky shërbim esencial dhe themelor për shëndetin psiko-emocional të fëmijëve të mi, është dhunuar

dhe shkelur pa asnjë procedurë ligjore standarde siç e kërkon rregullorja e sipërcituar. Në çdo rast, autoriteti i arsimit parauniversitar dhe subjektet përgjegjës kanë detyrimin ligjor të informojnë prindërit mbi këto formalitete dhe teknikalitete të nevojshme, bazuar në interesin më të lartë të fëmijëve, pasi nuk mund të prezumohet dijenia e prindit për çdo akt ligjor dhe nënligjor që disiplinon fushën e veprimtarisë së posaçme të institucioneve të arsimit parauniversitar në Shqipëri.

Në lidhje me mungesat e fëmijëve të mi në shkollë.

Ankesat e pasqyruara në regjistrin elektronik janë të falsifikuara dhe të vëna në mënyrë abuzive dhe në kundërshtim me ligjin. Kjo pasi, si pasojë e dhunës së ushtruar ndaj fëmijëve të mi, këta të fundit i kam çuar vazhdimisht (për shkak se dhuna ka qënë sistematike dhe e shtrirë në kohë) tek mjekët specialistë si dhe psikologë të shtetit, ku janë pasqyruar edhe evidentuar edhe pasqyruar nga specialistët përkatës edhe çrregullimet emocionale e psikologjike ndaj fëmijëve të mi, veprime të cilat lidhen nga ana kazuale me veprimet e dhunës të ushtruara nga ana e mësuesve të shkollës.

Këtë shqetësim e kam ngritur vazhdimisht nga ana ime si ankues, mirëpo nëpunësit publikë të IA nuk i kanë marrë parasysh. Këto fakte i provoj edhe nga mesazhet e mia me mësuesit e shkollës ku u kam përcjellë edhe rekomandimet dhe raportet e mjekëve që kanë vizituar fëmijët e mi, por nga ana e tyre vazhdimisht nuk janë marrë parasysh.

Mbi sa sipër, ju argumentojmë posaçërisht edhe për pretendimin (argumentin) citojmë:

“Ashtu siç kemi kemi shpjeguar edhe më lart mbi frekuentimin e tre nxënësve A.M, S.M dhe O.M në shkollën “Hasan Prishtina”, që përbëjnë numrin më të madh të mungesave, janë të pajustificuara nga ajo shkollë. Në fund të vitit shkollor, pa u mbyllur ende rezultatet nga mësuesit, për interesin më të lartë të fëmijëve, i jemi drejtuar drejtorisë së shkollës “Hasan Prishtina” me shkresë zyrtare më datë 24.06.2024, me nr. 148 Prot., ku përsëri nuk ka dhënë një përgjigje lidhur me këtë fakt.

Nga ana tjetër, shkolla “Ardian Klosi”, po në parashtrimet e relatuar me shkrim përpara KMD-së, është shprehur (citojmë):

“Drejtuesja e shkollës “Hasan Prishtina” nuk e pranon një fakt të tillë, ajo pohon se nxënësit transferohen vetëm nëpërmjet sistemit “SMIP” dhe nuk ka patur një kërkesë aktive në sistem, (bashkëlidhur kthimi përgjigjes nga shkolla Hasan Prishtina)”.

Mbi sa sipër u citua nga deklaratimet e dhëna nga shkolla “Ardian Klosi”, ju theksojmë se deklaratat e tyre janë të papranueshme dhe kontradiktore me njëra-tjetrën - sikundër edhe me provat e vëna në dispozicion të KMD-së nga subjekti ankues.

Ky i fundit i ka vënë në dispozicion KMD-së, përgjigjen elektronike me “email” nga shkolla “Hasan Prishtina”, ku ky institucion, krejt ndryshe sa deklarohet, pranon faktin se fëmijët e mi e

kanë frekuentuar këtë shkollë. Ky email gjendet integralisht së bashku me provat e tjera të vëna në dispozicion KMD, çka provon fiktivitetin e mungesave të vëna nga shkolla "Ardian Klosi", e cila madje, ka pohuar se mungesat e supozuara të fëmijëve të subjektit ankues, në shkollën "Hasan Prishtina", përbëjnë njëherazi dhe numrin më të lartë të mungesave.

Fiktiviteti i këtyre mungesave provohet edhe nga fakti tjetër, konkretisht, frekuentimi i provimeve finale nga ana e fëmijëve të mi, në fund të vitit akademik 2023-2024, në shkollën "Ardian Klosi". Njëri nga fëmijët e mi, konkretisht O.M, ka shprehur vullnetin në fletën e provimit se, nuk mund ta zhvillojë dot atë (provimin) për shkak se ishte i stresuar.

Ndaj për sa sipër, në kushtet ku shkolla "Ardian Klosi" ka pretenduar se fëmijët e mi nuk kualifikohen në vitin pasardhës, për shkak të mungesave, krejt kundër (duke e ditur se fëmijët e mi kanë qënë në shkollën Hasan Prishtina ku dhe kanë zhvilluar mësim për llogari të kësaj shkolle) i kanë pranuar fëmijët e mi në provimet finale të vitit akademik 2023-2024.

Së fundmi, ju theksojmë se, në fund, mësuesit P.Gj i është dhënë masa disiplinore ekstreme e largimit nga puna, nga ana e Drejtorit të Shkollës "Ardian Klosi". Madje vetë ky institucion ka pranuar faktin se z. P.Gj ka ushtruar dhunë ndaj fëmijëve të mi, megjithatë, masa disiplinore e "largimit nga puna" në mënyrë të kundërligjshme është dhënë për motivacionin e "shkeljeve në komunikim me eprorin e institucionit".

Pra kur subjekti P.Gj ka shkelur etikën me eprorin e institucionit - menjëherë është marrë masa ekstreme e largimit nga puna dhe kur fëmijët e mi dhunoheshin sistematikisht nga ky subjekt, pohohej se nuk kishte ushtruar dhunë - por megjithatë, sërish i jepnin masën vërejtje".

Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 151, datë 20.01.2025, subjekti ankues ka dërguar shkresat e dërguara nga Njësia Bashkiake nr. 4, Tiranë, datë 14.10.2024, në të cilat vihen në dijeni ankuesi dhe institucionet: MAS, AKAP, DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë, se: *"Specialistja për Mbrojtjen e fëmijëve në NJA nr. 4, në bashkëpunim dhe me inspektorin e zonës (SPZ) verifikoi në terren të miturit A.M, S.M dhe O.M dhe rezulton se ata janë larguar jashtë shtetit dhe për këtë arsye nuk frekuentojnë vitin akademik në shkollën Ardian Klosi".*

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 93, datë 13.01.2025 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 23.01.2025, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesi z. A.M, dhe palëve kundër së cilëve është paraqitur ankesa, përfaqësueses me autorizim nr. 279/1, datë 17.01.2025, të MAS,

znj. I.N, përfaqësueses me autorizim nr. 393, datë 23.01.2025, të ZVAP, znj. R.K dhe Drejtoresha e shkollës “Ardian Klosi”, znj. J.I, ndërsa AKAP nuk u paraqit.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“... Pas ngjarjes, për dy javë jam ankuar sa tek ZVAP Tiranë dhe AKAP dhe fëmijët nuk i dërgova në shkollë se agresori ishte aty. Kërkova nga AKAP që shpërngulja e fëmijëve nga shkolla të bëhej me shkrim, për arsye të dhunës, dhe znj. R.A (drejtore) më tha se jam dakord. Më pas takova z. S.K dhe më tha se do e bësh transferimin nëpërmjet sistemit SMIP, dhe i thashë se nuk dua ti transferoj, dua ti shpërngul. Si përfundim më çojnë tek shkolla Hasan Prishtina dhe fëmijët kanë ndenjor rreth dy muaj atje. Fillimisht ishte gjithshka në rregull. Më pas z. K më thotë ose do i heqësh ti fëmijët ose do i heq unë nga shkolla, sepse nuk po bëja regjistrimin në SMIP.*

Arsyeja për dhunën e ushtruar ndaj fëmijëve të mi, mund të jetë se fillimisht kam qenë me ndihmë ekonomike dhe mua më shikonin nga këpucët me një lloj përçmimi.....

Shkak tjetër është se kam bërë dy herë denoncime në portal, në fillim të vitit shkollor (datë 10.09.2023) ku kam folur ashpër për shkollat në përgjithësi dhe për lëndët, matematikë dhe biologji. Këto lëndë i kam përmendur për fenomenin, nuk i godita si profesorë, por godita fenomenin e korrupsionit, etj”.

Gjatë seancës dëgjimore, drejtuesja e shkollës “Ardian Klosi”, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, ndërkohë që në mes të tjerash deklaroi ⁶ se: *“... Sipas procesverbalit të mbajtur për ngjarjen ka rezultuar se mësuesi i matematikës i ka tërhequr veshin A.M dhe mësuesja e biologjisë i ka tërhequr vëmendjen S.M gjatë orës së mësimi dhe i ka thënë që nuk është mirë të sillesh në këtë formë se tregon edukatën e marrë nga familja. Referuar procesverbalit, nuk është e vërtetë që fëmijët janë lënë në këmbë. Mësuesi i matematikës ka tërhequr veshin për arsye të mos qëndrimit korrekt gjatë orës së mësimi, i ka tërhequr disa herë vëmendjen dhe mendohet që i ka tërhequr dhe veshin.*

Pas masës disiplinore (vërejtje), mësuesi i matematikës i cili donte dhe 2-3 vjet për të dalë në pension, filloi axhitimin e tij sepse mendonte se masa ishte e padrejtë dhe në komunikimin që kam pasur me të, ai i ka tejkaluar pak normat e komunikimit.

Diku nga muaji mars 2024 ka ndodhur një episod i zakonshëm ngacmimi mes nxënësve, gjatë kohës së pushimit të madh. Dy fëmijët e z. A.M janë konfliktuar me një nxënës tjetër. Mësueset kujdestare kanë njoftuar prindërit e nxënësve, por z. A.M nuk ka ardhur në shkollë. Mua më ka telefonuar oficeri i policisë i zonës, i cili më ka thënë se është bërë një kallëzim për ju nga z. A.M. Kamerat për shkak të punimeve në zonë, herë pas here nuk punonin dhe atë ditë për shkak të mungesës së energjisë elektrike, kamerat nuk kanë regjistruar. Pas kësaj dite fëmijët nuk kanë frekuentuar më shkollën dhe kanë ardhur vetëm ditët kur kishin teste. I kemi kërkuar z. A.M që të bënte arsyetimin e mungesave, sepse numri i mungesave po rritej dhe kemi njoftuar dhe Njësinë e

⁶ Referuar deklaramëve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 38.00 e në vijim.

Mbrojtjes së Fëmijëve. I jam drejtuar dhe shkollës Hasan Prishtina dhe kam marrë përgjigje se në shkollën Hasan Prishtina nuk ka patur asnjë kërkesë për lëvizje të këtyre fëmijëve.

Lidhur me deklarin e z. A.M për shkaqet informoj se asnjë herë nuk e kam parë z. A.M nga këpucët dhe e kam pritur shumë herë pa asnjë problem. Unë sot po e marr vesh që z. A.M ka një faqe të tijën online, kështu që nuk ka shprehur asnjëherë asnjë lloj shqetësimi. Është paraqitur në shkollë si prind i tre fëmijëve dhe jo si administrues i një faqeje online, për të cilin nuk kam asnjë lloj informacioni. Lidhur me gjendjen ekonomike të familjeve të fëmijëve që ndjekin shkollën “Ardian Klosi”, informoj se është në Njësinë Administrative nr. 4, ndodhet afër Bregut të Lumit dhe pjesa më e madhe e familjeve janë të një niveli nënmesatar dhe mesatar, kështu që asnjëherë z. A.M nuk është trajtuar, as parë në këtë këndvështrim”.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e ZVAP Tiranë i qëndroi të njëjtave parashtime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe deklaroi⁷ se: “ZVAP nuk ka dhënë asnjë urdhër për kalimin e nxënësve në një shkollë tjetër, pasi çdo transferim duhet të bëhet nga sistemi SMIP, i cili administrohet nga AKSHI dhe jo nga ZVAP. Gjithashtu nuk kemi dijeni se z. A.M është administratori i një faqeje online”.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e MAS i qëndroi të njëjtave parashtime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe deklaroi⁸ se: “Kemi pasur disa kërkesa nga ankuesi. Siç u tha dhe këtu, transferimi i fëmijëve bëhet nga prindi. Nga shqyrtimi i dokumenteve rezulton se episodi i dhunës ndaj fëmijëve ka ndodhur në datë 15.09.2023 dhe e gjithë procedura dhe vendimmarrja është ndjekur nga institucioni arsimor, i cili ka marrë masat sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu nuk kemi dijeni se z. A.M është administratori i një faqeje online”.

Në vijim të seancës dëgjimore, subjekti ankues me email-et datë 12.02.2025 dhe 23.02.2025, në mes të tjerash informoi Komisionerin si më poshtë: “..... Përfaqësuesja e MAS, në seancë dëgjimore para KMD ka pretenduar se nuk ka një ankesë nga subjekti ankues mbi faktin e bullizimit dhe paragjyqimit të fëmijëve për shkak të statusit të tij si administrator i portalit Zhurma.AL. Pra, në mënyrë implicite kjo gjë çon në deduksionin logjik se, kur ankesat lidhen me dhunën e ushtruar nga mësuesit ndaj fëmijëve, nuk merren parasysh nga MAS, kurse në eventualitetin e të pasurit një shkak të paragjyqimit të fëmijëve, për shkak të prindit, u marrkan parasysh. Ky fakt është provues i qartë i neglizhencës dhe shmangies së qëllimshme që ky institucion tenton të shkaktojë, me qëllim për tu shmangur nga thelbi i çështjes dhe diskriminimit të fëmijëve të mi nga ky institucion. Ankesat dhe kërkesat e mësipërme shprehin pa asnjë ekuivok shqetësimin tim si prind mbi nevojën për të arsimuar fëmijët e mi në një shkollë dinjitoze dhe ku nuk ushtrohet dhunë ndaj tyre....

Lidhur me AKAP, informoj se: Kam shkuar disa herë së bashku me fëmijët, kemi zhvilluar disa herë mbledhje verbale me drejtoreshën znj. A si dhe Drejtoreshën e Kurrikulës në këtë

⁷ Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 01.03.50.

⁸ Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 01.09.45.

institucion. Këto subjekte na kanë përcjellë gjithmonë me fjalë ngushëlluese dhe na kanë siguruar se i gjithë procesi do të shkojë në rregull dhe sipas procedurave. Unë si ankues nuk e kam problemin tek premtimet që më kanë bërë mua, pasi unë jam regjur me të tilla “premtime”, por problemin thelbësor e kam patur tek fëmijët e mi të cilët shpresonin në fjalët e subjekteve të mësipërm dhe zhgënjeheshin. Komunikimi i tyre ka sjellë pasojën e mosbesimit të fëmijëve të mi tek ata që i edukojnë si dhe tek sistemi parauniversitar në tërësi.

Gjithashtu jam paraqitur sërish për të fundit herë në këtë institucion së bashku me fëmijët e mi, ku i kam vënë në dijeni mbi mungesat fiktive të vëna nga ana e shkollës “Ardian Klosi” kundrejt fëmijëve të mi. Ky takim është zhvilluar në prezencë fizike të drejtoreshës znj. A. dhe Drejtoreshës së Kurrikulës së institucionit. Gjithashtu kemi takuar edhe Specialistin e DPAP, i njohur me emrin E. Specialisti në fjalë ka qenë prezent së bashku me një vajzë tjetër për inspektim në shkollën “Ardian Klosi”, të cilët kanë mbajtur një procesverbal ku kanë konstatuar faktin se, z. P.Gj ka mbajtur fëmijën A, 45 minuta në tualetin e shkollës.

Këto fakte janë pasqyruar procesverbalin e datës 20.12.2024, mbajtur nga të lartpërmendurit. Në të njëjtën ditë i kam vënë në dijeni për goditjen fizike të fëmijës së mësuesit B.L, nga i njëjti “agresor”, konkretisht shtetasi P.Gj. Informoj KMD se, mësuesi B.L njëhej në personelin e mësuesve si “miku” im (subjektit ankues).

Lidhur me ZVAP Tiranë, informoj se: Z. S.K ka urdhëruar transferimin e fëmijëve të mi, pa asnjë formalitet ligjor, në shkollën “Hasan Prishtina”, që dokumentohet nga biseda verbale që unë subjekti ankues kam zhvilluar me të në zyrën e tij në ZVAP. Siç vërehet qartë nga shkresat zyrtare të mësipërme, si subjekt ankues, e kam vënë në dijeni këtë institucion në mënyrë sistematike mbi problemin tim si prind, sa i përket nevojës për të arsimuar fëmijët e mi në një institucion shkollor serioz, ku nuk ushtrohet dhunë ndaj tyre. ZVAP-ja nuk rezulton të ketë marrë asnjë masë për adresimin e këtyre problematikave të ngritura në mënyrë të vazhdueshme nga ana ime.

Lidhur me shkollën “Ardian Klosi”, informoj se: Drejtoresha e këtij institucioni, në seancë dëgjimore para KMD ka pranuar pjesërisht dhunën sistematike të ushtruar ndaj fëmijëve të mi. Ky subjekt ka artikuluar faktin se, fëmijët e subjektit ankues janë pajisur edhe me libra dhe mjete të tjera didaktike për zhvillimin e procesit mësimor, sikur fëmijët e mi, ndryshe nga fëmijët e tjerë, kanë cilësi të veçanta, duke pohuar indirekt një formë të “favorizimit” të fëmijëve të mi, në garantimin e një të drejte ligjore që u garantohet të gjithë fëmijëve të tjerë, në kushte të barabarta. Është e pakuptueshme se për çfarë arsyeje pohohet ky fakt, ku detyrimi për të pajisur fëmijët me tekste shkollore është një detyrim ligjor i ditur botërisht. Pra indirekt, konfirmohet fakti se, sjellja e paligjshme pa asnjë mëdyshje ka të bëjë edhe me gjendjen ekonomike të personit tim si subjekt ankues (në momentin e fillimit të regjistrimit të fëmijëve të mi në këtë institucion shkollor)”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të nxënësve O, S dhe A.M, të përfaqësuar nga prindi z. A.M, nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”, ZVAP Tiranë, AKAP dhe MAS.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e subjektit për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD, i ndryshuar, në nenin 32/2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga këqyrja e dokumentacionit, deklarimeve të palëve dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

- *Lidhur me trajtimin e ankesës datë 15.09.2025, të bërë nga prindi Z. A.M.*

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se në vitin shkollor 2023-2024, O.M ishte nxënës në klasën e VI-të dhe S dhe A.M ishin nxënës në klasën e VII-të, në shkollën “Ardian Klosi” Tiranë.

Në datë 15.09.2023, z. A.M i është drejtuar me një ankesë Drejtorisë së shkollës “Ardian Klosi” në të cilën ka deklaruar për fëmijët A dhe S.M se: *“Sot ditën e premte datë 15.09.2023 në orën e matematikës profesor P.Gj ka bullizuar dhe i ka tërhequr veshin dhe e ka qëlluar me shpullë në kurriz djalin tim në prezencë të të gjithë nxënësve. Po sot mësuesja e biologjisë H.Z e ka goditur me shkurës dhe ka dënuar djalin tjetër duke e lënë në këmbë për një orë mësimi, pastaj erdhi*

kujdestarja e klasës dhe ajo e ka ulur djalin në bangë. Sa doli mësuesja kujdestare, mësuesja e biologjisë e ngriti përsëri djalin në këmbë, një orë tjetër mësimi..... kërkoj të merren masa sipas rregullores dhe ligjit”.

Drejtoria e shkollës me shkresën nr. 523, datë 18.09.2023, i është drejtuar Komisionit të Etikës, për shqyrtimin e ankimit të prindit A.M.

Lidhur me trajtimin e kësaj ankese, psikologu i shkollës E.K ka zhvilluar takim me të gjithë nxënësit e klasës VII-A, të cilët i ka pyetur për ngjarjen dhe ka mbajtur procesverbalin datë 18.09.2023, në të cilin ka informuar se: *“.... Pasi shqyrtova informacionin e vënë në dispozicion, dëgjova dëshmitë e nxënësve të klasës VII-A, dy nxënësve ankimuese dhe mësuesve, arrij në konkluzionin se ndaj dy nxënësve nuk është ushtruar dhunë, ofendim apo diskriminim verbal. Nëse ka pasur shkelje të etikës së komunikimit, kjo do të shqyrtohet nga Komisioni Etikës”.*

Me shkresën nr. 515, datë 19.09.2023, shkolla Ardian Klosi, ka raportuar tek ZVAP Tiranë lidhur me shqyrtimin e ankesës, deri në atë fazë.

Referuar dokumentit: Përgjigje për ankesën, Shtojca nr. 7, datë 20.09.2023, Komisioni i Etikës në përfundim të shqyrtimit të ankesës së z. A.M, në mes të tjerash ka informuar se: *“Si fillim në prani të psikologut dha versionin e tij nxënësi A.M, i cili ka pohuar pretendimet e tij. Është pyetur dhe profesori i matematikës P.Gj i cili nuk pranon që e ka ofenduar nxënësin siç ai pretendonte, por ka sqaruar situatën. Ka pranuar që e ka prekur lehtë nga veshi në formë shakaje. Për këtë veprim profesori kërkoi disa herë ndjesë në prani të komisionit. Ndjesë e cila nuk u pranua as nga fëmija as nga nxënësi.*

Për këtë gjë Komisioni i Etikës vendosi në bazë të nenit 39, pika 7, shtojca 7, ti propozojë Komisionit të Disiplinës masën disiplinore: Qortim.

Komisioni i Etikës gjithashtu shqyrtoi edhe rastin e ndodhur gjatë orës së biologjisë.

Mësuesja pranon që ka ngritur S.M në dërrasë, por jo si dënim, por për të lexuar ato që mësuesja kishte shkruar në dërrasë gjatë shpjegimit dhe deklaroi se ka thënë vetëm: “Nëse një fëmijë nuk sillet mirë në klasë, turpëron familjen e tij”. Mësuesja kërkoi disa herë ndjesë në prani të komisionit nëse është fyer nga fjalët e mësueses, ndjesë e cila nuk u pranua as nga fëmija as nga nxënësi.

Për këtë gjë Komisioni i Etikës vendosi në bazë të nenit 39, pika 7, shtojca 7, ti propozojë komisionit të Disiplinës masën disiplinore: Qortim”.

Referuar procesverbalit datë 21.09.2023, Komisioni i Disiplinës të shkollës gjatë shqyrtimit të ankesës së z. A.M, ka dëgjuar informacionin dhe procesverbalet e mbledhura nga Komisioni i Etikës ka dëgjuar dhe njëherë detaje dhe informacion nga psikologu i shkollës, dhe në përfundim të votimit të fshehtë të anëtarëve të Komisionit të Disiplinës ka vendosur marrjen e masës “Vërejtje” për z. P.Gj dhe masën “Qortim” për znj. H.Z.

Shkolla Ardian Klosi me Vendimin nr. 10, datë 22.09.2023 dhe nr. 11, datë 22.09.2023, ka marrë masat disiplinore “Vërejtje” për mësuesin P.Gj dhe masën “Qortim” për mësuesen H.Z.

Me shkresën nr. 530, datë 26.09.2023, shkolla Ardian Klosi ka njoftuar z. A.M, lidhur me masat disiplinore të marra, në përfundim të shqyrtimit të ankesës së tij datë 15.09.2023.

Në nenin 54, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se drejtori i institucionit arsimor: “1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. 2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për: a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; b) c)..... ç).....”.

Në nenin 62 të ligjit 69/2012, të ndryshuar, parashikohet se: “Të drejtat dhe detyrat e prindërve: 2. Prindi ka të drejtë: a) të informohet nga institucioni arsimor përkatës për legjislacionin arsimor në fuqi, për rregulloren e institucionit dhe për kurrikulën që institucioni i ofron fëmijës së tij; b) c) të informohet për veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe të japë pëlqim për veprimtaritë plotësuese dhe jashtëshkollore që organizon shkolla;..... 3. Prindi ka detyrë: a) të kujdeset që fëmija i tij të ndjekë rregullisht institucionin arsimor dhe të mësojë rregullisht; b) të njoftojë për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij; c) të marrë pjesë në takimet për që kanë të bëjnë me fëmijën e tij;”.

Në zbatim të ligjit për arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, ka miratuar Rregulloren për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare.

Në Rregulloren e sipërcituar parashikohet si më poshtë:

“Neni 39. Veprimtaria e komisionit të etikës dhe sjelljes. 1. Komisioni trajton të gjitha ankesat që i paraqiten me shkrim brenda objektit të veprimtarisë së tij. 4. Komisioni shqyrton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara në seancën dëgjimore për palën ndaj të cilës propozohet masa disiplinore. Në rastet kur vërtetohet se pala ka kryer shkelje të etikës dhe rregullores së brendshme të IA-së, përveç rasteve kur ato përbëjnë vepër penale, komisioni propozon masa sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. 5. Në rastet kur ankues është nxënësi, komisioni ka detyrimin që në procedurën e ballafaqimit të ketë të pranishëm psikologun apo punonjësin social. 6. Komisioni, në përfundim të shqyrtimit të ankesës i propozon drejtorit të IA-së masën disiplinore për çështjet e ngritura në ankesë, në përputhje me parashikimet e rregullores. Vendimmarrja i takon komisionit të disiplinës.

Neni 42; 1. Drejtori i institucionit arsimor është titullari i institucionit, që ka të drejtën e firmës dhe të vulës së institucionit. 2..... 3. Drejtori ka përgjegjësinë për zbatimin në institucionin arsimor të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi;

Neni 56; 2. Mësuesi ka për detyrë: c) të trajtojë këdo, në mjediset e IA-së, me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme, pa presione, pa padrejtësi, pa fyerje, pa diskriminim, pa dhunë;

Neni 69. Trajtimi i sjelljeve të dhunshme të mësuesit ndaj nxënësit; 1. Përdorimi i dhunës verbale, psikologjike, fizike apo seksuale nga ana e mësuesit ndaj nxënësve është i ndaluar. 2. Në rastin e konstatimit të dhunës, nxënësi, ndaj të cilit është ushtruar dhunë, ka të drejtë të ankohet te mësuesi kujdestar ose psikologu/punonjësi social i IA-së, të cilët njoftojnë drejtorin e institucionit. 3. Drejtori e paraqet rastin para komisionit të etikës dhe sjedhjes. 4. Kur ky komision konstaton kryerjen e shkeljes nga ana e mësuesit, bën rekomandimin për drejtorin e IA-së për marrjen e masës disiplinore ndaj mësuesit, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore.

Neni 101. Komisioni i disiplinës. 6. Komisioni i disiplinës në IA shqyrton rastet e konstatuara nga komisioni i etikës dhe sjelljes për shkeljet disiplinore të kryera nga ana e nxënësve, mësuesve dhe nëndrejtorëve.

Neni 107. Masat disiplinore për mësuesit dhe nëndrejtorin. 1. Komisioni i disiplinës i IA-së jep masën disiplinore për mësuesin ose nëndrejtorin, kur: a) konstaton shkelje të legjislacionit në fuqi për arsimin parauniversitar, të kësaj rregulloreje ose të rregullores së brendshme të institucionit;....

2. Masat e përshkallëzuara që komisioni i disiplinës vendos për mësuesin ose nëndrejtorin, në varësi të llojit të shkeljes apo përsëritjes së të njëjtës shkeljeje, janë: a) qortim; b) vërejtje; c) paralajmërim për largim nga puna; ç) largim nga puna.

4. Masa është e shlyer kur, për një periudhë gjashtëmujore, komisioni i disiplinës nuk ka shqyrtuar shkelje tjetër të mësuesit/nëndrejtorit.

5. Në rastet kur mësuesi/nëndrejtori ka ushtruar dhunë ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit, dhe këto veprime janë të provuara, jepet masë disiplinore “largim nga detyra”, përveç veprimeve të tjera që mund të ndiqen nga strukturat kompetente sipas legjislacionit në fuqi”.

Në pikën 9 të Kreut III të, VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, përcaktohet se: “Drejtoritë Rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal dhe kryejnë këto detyra: a) Menaxhojnë, mbikëqyrin, vlerësojnë dhe kontrollojnë institucionet arsimore parauniversitare për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi....b) c)”.

ZVAP Tiranë, bazuar në ankesën e bërë nga z. A.M në datë 18.09.2023, me Urdhrin nr. 295, datë 27.09.2023, ka ngritur grupin e punës për trajtimin dhe vlerësimin e ankesës së prindit Z. A.M kundër mësuesit të shkollës Ardian Klosi.

Referuar Raport Monitorimit në shkollën Ardian Klosi, nr. 5202/4, datë 02.10.2023, grupi i monitorimit i ZVAP Tiranë, ka arritur në përfundimin se: *“1. Masat disiplinore të marra për dy mësuesit P.Gj dhe H.Z janë zbatuar si duhet, si përcaktohen në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar. 2. Në shkollë sipas rezultateve të pyetësorit ka një klimë pozitive dhe etikë në komunikim nga ana e mësuesve, pavarësisht ndonjë rasti sporadik nga ana e mësuesve”.*

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 5202/2, datë 02.10.2023, ka njoftuar z. A.M mbi përfundimet e trajtimit të ankesës së tij, nëpërmjet përfundimeve të dala nga raporti i monitorimit.

Drejtoria e shkollës Ardian Klosi me shkresën nr. 646/1, datë 20.12.2023, i ka kërkuar psikologut të shkollës që të verifikojë rastin e ankesës së përsëritur të z. A.M ndaj mësuesit P.Gj për ushtrim dhunë fizike.

Referuar dokumentit “Rezultatet e pyetësorit me nxënësit e klasave VII-A dhe VIII-B” të hartuar nga psikologu i shkollës E.K, pas kërkesës së drejtores së shkollës, në datë 20.12.2023, përshkruhet se: *“Me datë 20.12.2023 mua E.K psikolog i shkollës më është paraqitur një kërkesë nga drejtoria e shkollës, në të cilën bëhej e ditur se prindi Z. A.M sërish kishte ngritur pretendimin se fëmijët e tij vijonin të ofendoheshin me fjalë, dhunoheshin fizikisht dhe psikologjikisht nga profesori i matematikës P.Gj. Për të marrë një informacion të plotë dhe të paanshëm zhvillova një takim me nxënësit pa praninë e asnjë mësuesi, dhe pastaj zhvillova një pyetësor për të marrë informacion më të gjerë dhe të detajuar me nxënësit e klasave VII-A dhe VIII-B, në të cilat profesori jep mësim..... Në konkluzionet e këtij pyetësori psikologu i shkollës ka informuar dhe se: “Në pyetjen me shkrim, 12 nxënës nga 36 që plotësuan pyetësorin (33.3%) kanë përshkruar situata ku janë ofenduar, prekur fizikisht apo goditur nga mësuesi P.Gj”.*

Me shkresën nr. 651, datë 29.12.2023 “Vendim për zgjidhjen e kontratës së punës”, Drejtoria e shkollës Ardian Klosi ka njoftuar mësuesin P.Gj për zgjidhjen e kontratës së punës për: *“- Përdorim në mënyrë të përsëritur i dhunës fizike dhe psikologjike ndaj nxënësve të shkollës. – Shkelje të rëndë të etikës në komunikim me titullarin e institucionit. – Mosrealizimin brenda afateve kohore të detyrave funksionale si mësues. – Mosshlyerje e masës disiplinore Vërejtje të marrë me datë 29.12.2023”.*

Referuar relacionit datë 09.01.2024, të përgatitur nga psikologu i shkollës, rezulton se atë ditë është zhvilluar një takim mes drejtores së shkollës, psikologut të shkollës dhe prindit Z. A.M, të cilët e kanë informuar mbi hapat e ndjekur për verifikimin e ankesës së tij të datës 20.12.2023 dhe masat e marra ndaj mësuesit P.Gj.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar dhe legjislacionit sipërcituar, rezulton se shkolla Ardian Klosi, ka shqyrtuar ankesën e z. A.M, bazuar në parashikimet e Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, Rregullore për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare.

Referuar procesverbaleve të psikologut të shkollës, të Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Disiplinës, rezulton se këto komisione pasi kanë shqyrtuar provat dhe faktet në dispozicion, kanë dëgjuar nxënësit e klasës, mësuesit e shkollës, nxënësit A dhe S.M, mësuesit P.Gj dhe H.Z, nuk

kanë konstatuar elementë të mirëfilltë të dhunës ndaj nxënësve dhe kanë propozuar masat disiplinore, vërejtje dhe qortim.

Gjatë shqyrtimit të ankesës datë 15.09.2025, të z. A.M, Komisioni i Etikës, psikologu i shkollës dhe Komisioni i Disiplinës, kanë arritur në përfundimin se ka pasur shkelje nga ana e mësuesit P.Gj dhe H.Z, por këto shkelje nuk kanë qenë të një masë të tillë, sa të konsideroheshin si përdorim dhunë, sipas legjislacionit në fuqi dhe kanë propozuar masë disiplinore në proporcion me gjetjet e konstatuara/provuara.

Në rastin e ankimit të z. A.M, Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Disiplinës së shkollës Ardian Klosi, nuk kanë arritur të provojnë se ndaj nxënësve A dhe S.M të jetë ushtruar dhunë, sipas parashikimeve të nenit 107, pika 5, të Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare, gjithashtu dhe nga ana e ZVAP Tiranë është arritur në përfundimin se masat disiplinore të marra për mësuesit, janë marrë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin parauniversitar.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, shkolla Ardian Klosi dhe ZVAP Tiranë kanë zbatuar legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet arsimore, duke shqyrtuar dhe trajtuar rastin sipas fakteve dhe provave të grumbulluara nga palët, nëpërmjet psikologut të shkollës, Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Disiplinës dhe se nxënësit S dhe A.M, nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e shkollës Ardian Klosi dhe nga ZVAP Tiranë.

- *Lidhur me frekuentimin e shkollës nga ana e nxënësve O, S dhe A.M.*

Referuar shkresës nr. 531, datë 26.09.2023, të shkollës Ardian Klosi drejtuar ZVAP Tiranë, lidhur me raportimin për ankesën e z. A.M, në mes të tjerash raportohet se: “...Ditën e hënë (datë 25.09.2023) ka vijuar mësimi normalisht, nxënësit kanë qenë në shkollë, Ditën e martë (datë 26.09.2025) është paraqitur në shkollë prindi Z. A.M dhe ka kërkuar të tërheqë fëmijët e tij nga shkolla...”.

Me shkresën/ankesë datë 26.09.2023, z. A.M i është drejtuar AKAP-së, në të cilën ka referuar ngjarjen e ndodhur në datë 15.09.2023 dhe në përfundim i ka kërkuar “... një shkollë të saktë ku të shkollojë fëmijët e tij”.

Z. A.M me kërkesë/ankesën datë 03.11.2023 dhe kërkesën datë 22.04.2024, i është drejtuar MAS-it, në të cilën ka kërkuar nxjerrjen e një akti për shpërnguljen/largimin e nxënësve S, O dhe A.M nga shkolla Ardian Klosi.

MAS me shkresat nr. 6977/1, datë 15.11.2023, dhe nr. 2690/1, datë 07.05.2024, i ka kthyer përgjigje z. A.M duke e informuar se duhet të ndiqni procedurat ligjore për transferimin e nxënësve, duke aplikuar në sistemin e-albania.

Shkolla Ardian Klosi me shkresën nr. 636, datë 11.12.2023, ka vendosur ngritjen e grupit të punës që të marrë takim me z. A.M, për rikthimin e nxënësve në shkollë.

Shkolla Ardian Klosi me shkresën datë 07.12.2023, drejtuar z. A.M ka njoftuar këtë të fundit se: *“... duke qenë se jemi në mbyllje të periudhës së parë, jemi të shqetësuar në lidhje me mosfrekuentimin e fëmijëve tuaj, pasi që nga data 26.09.2023, O dhe S nuk kanë frekuentuar më, ndërsa A është rikthyer me datë 20.10.2023 dhe që nga data 17.11.2023 nuk është paraqitur më në shkollë. Ne si shkollë ju kërkojmë që të riktheni fëmijët në shkollë në mënyrë që të vijojmë me shlyerjen e detyrimeve shkollore (realizimin e testeve)”*.

Në vijim të mungesave në shkollë të fëmijëve të z. A.M, psikologu i shkollës, me email-in datë 12.04.2024, nëpërmjet Formularit të Raportimit të Fëmijës në Nevojë për Mbrojtje, ka raportuar rastin pranë Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve të Njesisë Administrative nr. 4, Tiranë, duke informuar në mes të tjerash se: *“...fëmijët prej datës 20.03.2024 nuk frekuentojnë rregullisht procesin mësimor në shkollë, por paraqiten vetëm në orët që kanë për të zhvilluar testet e tremujorit të dytë..... Si psikolog i shkollës kam kontaktuar me anë të telefonit me babain e nxënësve në datë 28.03.2024, ku i kërkoja që nxënësit të referohen për trajtim psikologjik, por prindi nuk ka pranuar duke u shprehur se shkolla është në konflikt interesi dhe fëmijët do ti dërgonte privatisht te një psikolog...”*.

Shkolla Ardian Klosi me shkresën nr. 121, datë 08.05.2024, ka njoftuar përsëri specialisten për mbrojtjen e fëmijëve pranë Njesisë Administrative nr. 4, duke e informuar se nga data e referimit të fëmijëve (12.04.2024) dhe deri më sot datë 08.05.2024, nxënësit A, S dhe O.M nuk janë paraqitur në shkollë dhe babai i fëmijëve është njoftuar rregullisht nga mësueset kujdestare mbi rrezikun e arritjes së numrit të mungesave që i bën ato të pakualifikuar për vitin shkollor 2023-2024.

Me shkresën datë 22.04.2024, drejtuar ZVAP Tiranë, z. A.M ka kërkuar motivacionin me shkrim përse fëmijët e tij po largohen nga shkolla Ardian Klosi me qëllim që kur ti regjistrojë në shkollën tjetër, të jenë të pajisur me dokument që të dihet situata e fëmijëve të tij.

Më shkresën nr. 2613/1, datë 26.04.2024, ZVAP Tiranë ka informuar z. A.M se: *“Transferimi i tre fëmijëve tuaj nga shkolla Ardian Klosi në një shkollë tjetër është e drejta juaj si prind dhe këtë të drejtë mund ta ushtroni duke aplikuar në sistemin e-albania. ... ZVAP Tiranë garanton se pas aplikimit për transferimin e fëmijëve tuaj nëpërmjet sistemit e-albania, ne miratojmë transferimin menjëherë”*.

Shkolla Ardian Klosi me shkresën nr. 117, datë 02.05.2024, drejtuar prindit Z. A.M dhe ZVAP Tiranë ka vënë në dijeni z. A.M se fëmijët e tij kanë kaluar 35% të orëve vjetore lëndore të mungesave dhe për këtë arsye nuk klasifikohen në asnjë lëndë.

Lidhur me ngjarjen e datës 19.03.2024 të ndodhur gjatë pushimit të madh në mjediset e jashtme të shkollës Ardian Klosi, në të cilën janë konfliktuar nxënësit O, S dhe A.M me nxënësin L.C, referuar procesverbaleve të mbajtura nga mësueset kujdestare L.C, J.K, Xh.I, psikologu i shkollës

E.K dhe nga oficeri i policisë gjyqësore S.K, rezulton se nga ana e shkollës janë marrë masat për evidentimin e ngjarjes dhe janë lajmëruar prindërit e nxënësve për ngjarjen. Prindi i nxënësit L.C është paraqitur në takim dhe është informuar për ngjarjen dhe vetë nxënësi ka treguar versionin e tij, ndërsa z. A.M nuk është paraqitur në shkollë bashkë me fëmijët.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se ngjarja është dokumentuar nga ana e personelit të shkollës, ndërsa rezulton se drejtoresha, nëndrejtoresha dhe psikologu i shkollës nuk kanë qenë prezent në momentin kur ka ndodhur konflikti. Rezulton se për ngjarjen nuk janë propozuar dhe marrë masa disiplinore për nxënësit që kanë marrë pjesë në konflikt, pasi fëmijët dhe z. A.M nuk ishin paraqitur për të dëshmuar për ngjarjen, nuk kishte pamje video të ngjarjes dhe se veprimet e mosveprimet e drejtuesve të shkollës po trajtoheshin nga prokuroria, pasi ngjarja ishte kallëzuar në polici, nga ana e prindit Z. A.M.

Shkolla Ardian Klosi me shkresën nr. 115, datë 29.04.2024 dhe email-in datë 30.04.2024, drejtuar shkollës Hasan Prishtina, ka kërkuar konfirmim zyrtar mbi frekuentimin e nxënësve O, S dhe A.M në shkollën Hasan Prishtina për periudhën tetor-nëntor 2023.

Me e-mail-in datë 02.05.2024, shkolla Hasan Prishtina ka informuar shkollën Ardian Klosi se në shkollën Hasan Prishtina, prindi i nxënësve O, S dhe A.M, nuk ka bërë zyrtarisht aplikim për tu transferuar në atë shkollë.

Me email-in datë 08.05.2024, drejtuar z. A.M, shkolla Hasan Prishtina, i ka kthyer përgjigje z. A.M duke e informuar si më poshtë: *“...Me datë 02.10.2023 ju jeni paraqitur në shkollë duke kërkuar që fëmijët tuaj të ndjekin mësimin pranë shkollës Hasan Prishtina. Kërkesa juaj është marrë në konsideratë nga ne duke u siguruar nga ana jonë një shërbim cilësor, sipas interesave, nevojave dhe mundësive të tyre, me shpresën për aplikim në sistem, duke qëndruar si dëgjues në shkollën Hasan Prishtina. Mbështetur në Urdhrin 589, datë 16.10.2024 të rregullores SMIP, ku çdo nxënës duhet të regjistrohet në rrugë elektronike nga e-albania kam kërkuar nga ju të regjistronit fëmijët nga SMIP-i. Pas datës 16.11.2023 fëmijët nuk kanë frekuentuar shkollën Hasan Prishtina, duke vazhduar frekuentimin dhe regjistrimin në SMIP në shkollën Ardian Klosi. Më poshtë po ju nis vijueshmërinë e nxënësve A, S dhe O.M të cilët kanë frekuentuar shkollën Hasan Prishtina për periudhën 03.10.2023 deri 16.11.2023, për O dhe S.M dhe për periudhën 03.10.2023 deri 19.10.2023 për A.M”.*

Shkolla Ardian Klosi me email-in datë 21.06.2024 dhe shkresën nr. 148, datë 24.06.2024, i është drejtuar shkollës Hasan Prishtina, në të cilën i ka kërkuar informacion nëse nxënësit O, S dhe A.M kanë qenë fizikisht në shkollën Hasan Prishtina për periudhën tetor-nëntor 2023.

Shkolla Hasan Prishtina me shkresën nr. 102, datë 27.06.2024, ka kthyer përgjigje duke informuar se: *“Ju kemi kthyer përgjigje brenda afateve kohore. Aktualisht kërkesa juaj nuk përputhet me afatet kohore që ju kërkon (ka mbaruar viti shkollor)”.*

Në Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, Rregullore për Funksonimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare, parashikohet si më poshtë:

“Neni 66; 3. Mësuesi kujdestar përkujdeset posaçërisht për: ç) ndjekjen e shkollës nga të gjithë nxënësit;

Neni 67; Bashkëpunimi i mësuesit kujdestar me prindërit: 2. Mësuesi kujdestar ka për detyrë: a) të informojë rregullisht personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore rreth mbarëvajtjes së fëmijëve të tyre;

Neni 75; Mungesat e nxënësve: II. Klasat IV-IX. 2. Kur nxënësi i klasave IV-IX ka munguar më shumë se 35% të orëve vjetore lëndore, nuk klasifikohet në atë lëndë...;

Neni 77; 1. Mungesat e nxënësit janë të arsyeshme kur justifikohen me raport mjekësor, ose nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore për arsye të jashtëzakonshme, ose kur ka kërkuar leje paraprakisht me një shënim sqarues dhe i është miratuar kërkesa nga mësuesi kujdestar. 2. Mësuesi kujdestar ka të drejtë të vlerësojë si të arsyetuara/të paarsyetuara mungesa deri në tri ditë mësimi gjatë një muaji;

Neni 78; Procedura e transferimit të nxënësve: 1. Transferimi i nxënësit si rregull, bëhet pas përfundimit të vitit shkollor ose pas përfundimit të njërit prej tremujorëve, kurse në raste të ndërrimit të vendbanimit gjatë vitit shkollor.

Neni 88; Të drejtat dhe detyrat e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore 2. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ka të drejtë të informohet nga institucioni arsimor për: d) veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe të japë pëlqim për veprimtaritë plotësuese e jashtëshkollore dhe ekskursionet që organizon shkolla. 4. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ka për detyrë: b) të njoftojë mësuesin kujdestar për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij. ... ç) të njoftojë mësuesin kujdestar në rastet kur fëmija i tij mungon dhe t'i arsyetojë këto mungesa.”.

Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023 ka miratuar “Rregulloren për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar” (SMIP).

Në Rregullore, parashikohet se: “7; ZVAP ushtron përgjegjësitë si më poshtë: 7. Miraton ose refuzon në mënyrë të argumentuar, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, aplikimet për transferim të nxënësve brenda dhe jashtë ZVAP-së, si dhe të nxënësve të ardhur nga jashtë shtetit.

Neni 11; Drejtori i shkollës ushtron përgjegjësitë si më poshtë: 10. Shqyrton aplikimet për regjistrim ose transferim, duke bërë miratimin/refuzimin sipas akteve ligjore në fuqi, brenda një afati kohor prej 5 ditësh.

Neni 14; Mësuesi kujdestar i klasës ushtron përgjegjësitë si më poshtë: 1. Arsyeton mungesat e nxënësve (me arsye/pa arsye) jo më vonë se dita e parë e çdo jave mësimore, për javën paraardhëse.

Neni 15; Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore, ushtron të drejtat si më poshtë: 1. Sheh të dhënat, mungesat, notat/vlerësimet e nxënësve të regjistruar në sistem si nxënës. 4. Aplikon, nëpërmjet e-albania, për transferimin e nxënësve”.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për shpërnguljen/transferimin e fëmijëve të tij në një shkollë tjetër, rezulton se ankuesi me shkresën datë 26.09.2023, ka kërkuar nga AKAP që ti sugjerojë një shkollë ku ti çojë fëmijët e tij.

Referuar informacionit të administruar (shkresa nr. 8715/1, datë 26.11.2024 dërguar nga ZVAP Tiranë) rezulton se ky institucion ka komunikuar/ndërmjetësuar mes ankuesit dhe shkollës Hasan Prishtina, që fëmijët e tij të ndiqnin mësimin në këtë shkollë, ndërkohë që prindi të aplikonte nëpërmjet sistemit në e-albania, për transferimin e fëmijëve të tij.

Referuar email-it datë 08.05.2024, të shkollës Hasan Prishtina drejtuar ankuesit Z. A.M, rezulton se prindi Z. A.M në datë 02.10.2023, ka kërkuar që fëmijët e tij të ndiqnin shkollën Hasan Prishtina dhe kërkesa është marrë parasysh nga kjo shkollë (në mënyrë informale) deri sa prindi të aplikonte në sistem sipas procedurave ligjore. Po sipas këtij emaili nga shkolla rezulton se nxënësit S dhe O.M kanë frekuentuar shkollën Hasan Prishtina për periudhën 03.10.2023 deri më 16.11.2023, dhe nxënësi A.M për periudhën 03.10.2023 deri më 19.10.2023.

Referuar korrespondencës mes shkollës Ardian Klosi dhe Hasan Prishtina, rezulton se shkolla Hasan Prishtina, duke qenë se frekuentimi i shkollës nga ana e tre nxënësve si dëgjues ka qenë informal dhe në shkellje të kuadrit ligjor për transferimin e nxënësve, ka informuar shkollën Ardian Klosi se prindi i fëmijëve M nuk ka bërë zyrtarisht aplikim për tu transferuar në shkollën Hasan Prishtina.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar (të dorëzuara nga shkolla) rezulton se fëmijët e subjektit ankues kanë munguar në procesin mësimor në shkollën Ardian Klosi, si më poshtë:

O.M, nxënës i klasës së VI-të, ka munguar nga data: 26.09.2023 deri në datë 13.12.2023; dhe datat 15-18-21-22.12.2023; datat 20-21-25-26-27-28-29.03.2024; dhe nga data 08.04.2024-30.04.2024; gjithsej 419 mungesa ose 44%.

A.M, nxënës i klasës së VII-të, ka munguar nga data: 26.09.2023 deri në datë 19.10.2023; dhe datat 24-27-31.10.2023; datat 8-13-17-30.11.2023; datat 20-24.11.2023; datat 1.12.2023 deri 12.12.2023 dhe 15.12.2023; datat 21-25-26-27-28-29.03.2024; dhe nga data 08.04.2024-09.05.2024; gjithsej 388 mungesa ose 37%.

S.M, nxënës i klasës së VII-të, ka munguar nga data: 26.09.2023 deri në datë 13.12.2023; dhe datat 20-21-25-26-27-28-29.03.2024; dhe nga data 08.04.2024-09.05.2024; gjithsej 474 mungesa ose 46%.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se MAS, si institucioni më i lartë që drejton sistemin arsimor në Shqipëri, me shkresën nr. 6977/1, datë 15.11.2023, e ka informuar z. A.M se

duhet të ndjekë procedurat ligjore për transferimin e nxënësve, duke aplikuar në sistemin e-albania.

Z. A.M, pavarësisht komunikimeve që kishte me shkollën “Ardian Klosi”, “Hasan Prishtina” dhe me institucionet e tjera të sistemit arsimor, në mënyrë informale ka dërguar fëmijët e tij sa në shkollën Hasan Prishtina dhe pastaj i ka kthyer përsëri në shkollën Ardian Klosi, deri sa ka vendosur që të largojë përfundimisht fëmijët nga shkolla, me arsyen se institucionet nuk po i jepnin me shkrim përgjigjen, se fëmijët e tij po shpërnguleshin nga shkolla Ardian Klosi për arsye të përdorimit të dhunës nga mësuesit.

Komisioneri vlerëson se, z. A.M në cilësinë si prindi i fëmijëve, duke pasur parasysh interesin më të lartë të tyre, për të ndjekur procesin mësimor-edukativ, duhet të ndiqte procedurat ligjore për transferimin e fëmijëve të tij, duke aplikuar nëpërmjet sistemit e-albania, dhe më pas të ndiqte të gjitha procedurat ligjore, për të ndjekur pretendimet e tij.

Referuar Urdhrit nr. 589, datë 16.10.2023, Rregullore e përdorimit të SMIP, rezulton se i vetmi opsion për transferimin e nxënësve, është që personi që ushtron përgjegjësinë prindërore të aplikojë nëpërmjet e-albania në sistemin SMIP dhe më pas ky aplikim miratohet/refuzohet nga shkolla dhe nga ZVAP.

Referuar dokumentacionit të sipërcituar, në përfundim të procesit mësimor, fëmijët e z. A.M kishin plotësuar numrin e mungesave, dhe në mungesë të justifikimit të tyre, shkolla ka vendosur moskualifikimin e tyre për vitin shkollor 2023-2024.

Referuar dokumentacionit të sipërcituar, shkolla Ardian Klosi, ka marrë të gjitha masat për informimin në vazhdimësi të prindit Z. A.M, lidhur me frekuentimin e procesit mësimor nga ana e fëmijëve të tij. Gjithashtu, shkolla Ardian Klosi, në zbatim të përgjegjësisë ligjore, ka informuar dhe ka kërkuar ndihmë dhe nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, të Njesisë Administrative nr. 4, lidhur me mosfrekuentimin e procesit mësimor nga ana e fëmijëve të z. A.M.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e Shkollës Ardian Klosi, ZVAP Tiranë, AKAP dhe MAS, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për shqyrtimin e ankesës së z. A.M të datës 15.09.2023 dhe për evidentimin e frekuentimit të procesit mësimor nga ana e fëmijëve të z. A.M.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Shkolla 9-vjeçare “Ardian Klosi”, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, kanë zbatuar legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet arsimore dhe se nuk kanë ndërmarrë veprime që kanë ekspozuar fëmijët e subjektit ankues ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e këtyre institucioneve, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Shkolla Ardian Klosi, ZVAP Tiranë, AKAP dhe MAS, kanë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësve O.M, S.M dhe A.M nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA